



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KUÇOVË**

**Data 05 / 11 / 2024**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT :**

“Rikualifikim i rrugëve Veiz Patriku, Labëria dhe sheshit të Perondisë”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**Kodi 45233120-6** (punime ndërtimi për rrugë).

**VLERA E FONDIT LIMIT :**

12 498 133,86 (*dymbëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e tre presje tetëdhjetë e gjashtë*) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kuçovë ka hartuar procesverbalin për argumentimin

dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë :

## **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë :

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

a. Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore, duke mbajtur në konsideratë dhe përcaktimet e Ligjit Nr 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, pranë njësive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e ti sipas QKB-së.

***Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.***

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

### **Për Taksat Lokale**

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9 përcaktohet se :

Në taksat vendore përfshihen :

1. Taksa vendore mbi biznesin e vogël.

2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore.

3. Taksa e fjetjes në hotel.
4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.
5. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.
6. Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve.
7. Taksa për zënien e hapësirave publike.
8. Taksa e tabelës.
9. Taksa të përkohshme.

Në nenin 14 po këtu, përcaktohet se : “1. Taksa paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiskal”.

**Bazuar mbi sa më sipër kërkesa e autoritetit kontraktor për pagesën e taksave lokale për vitin 2023 dhe 2024 është në përputhje me ligjin 9632 datë 30.10.2006 ”Për sistemin e taksave vendore”, ku ofertuesit për vitin 2024 kanë detyrimin për vërtetimin e pagesës të paktën për këstin e trete.**

## **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*)

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron minimale vjetore për tre vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 80% e fondit limit të kontratës që prokurohet.

*(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë :

Autoriteti kontraktor, në përcaktimin e vlerës së xhiros minimale vjetore (dhe konkretisht jo më pak se 80% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet) ka mbajtur në konsideratë nenin 43 pika 2 gërma b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku shprehimit thotë se :

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare .

---

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

- a) dyfishin e vlerës së përllogariturtë kontratës ose lotit<sup>1</sup>, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
- b) **vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;**
- c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me

anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji”.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë ofertues duhet të japin informacione në bilancet e tyre vjetore për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: *“Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shumën e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
  - b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 180 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.
- Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Për të vërtetuar përvojën e suksesshme në ekzekutimin e një kontrate të ngjashme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm :

- Për kontrata për punë publike të realizuar me institucione shtetërore kërkohen:

- a) *Kontraten/at e Sipërmarrjes,*
- b) *Situacion përfundimtare të objektit,*
- c) *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës përkatëse,*
- d) *Akt Kolaudimi*
- e) *Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore*

- Për kontrata për punë publike është realizuar me subjekte private kërkohen:

- a) *Kontraten/at e Sipërmarrjes,*
- b) *Situacion përfundimtare të objektit,*
- c) *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës përkatëse.*

d) *Akti i Kolaudimit*

e) *Faturat tatimore, Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë jo më e vogël se **40 %** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël **180%** të vlerës së fondit limit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

---

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

---

**2.3.2.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

## **PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI**

**1.** NP– 4 A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale

## **PUNIME SPECIALE NDËRTIMI**

## 1. NS - 18 A Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e liçensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjise, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në Nr.42, datë 16.01.2008).

**Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

### **PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI**

**NP- 4 A** (Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar **rrugët**, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, **punime të mureve mbajtëse**, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrore dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt.

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

Duke parë dhe vetë objektin e prokurimit i cili është **“Rikualifikim i rrugëve Veiz Patriku, Labëria dhe sheshit të Perondisë”** kjo kategori ndërtimi përkon dhe është në përputhje dhe



vëllim të plotë me investimin që do të kryhet (e cila përshtatet me çdo zë të preventivit të punimeve). Bazuar mbi objektin e prokurimit, qëllimi kryesor i autoritetit kontraktor është shtrimi i rrugës Veiz Patriku, Labëria dhe sheshit të Perondisë duke i siguruar banorëve të zonës kushte më të mira jetesë. Bazuar dhe nga preventive i punimeve ku përfshin punë të tilla si psh, shtresë çakëlli mbeturina kave t=10cm, shtresë stabilizanti 10cm, shtresë asfaltbetoni me zall lavatriçe 6cm me makineri etj, të cilat janë në përputhje me liçensën e mësipërme të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

## **PUNIME SPECIALE NDËRTIMI**

**NS - 18 A** ( Punime Topogjeodezike konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh )

Referuar natyrës së punimeve të mësipërme për këto të fundit, shfaqet e nevojshme disponueshmëria e kategorive të licencës për zbatim NS 18 - A, si punime të cilat përfshihen në grupin e punimeve parashikuar në lidhjen nr.3 të Vendimit 17 nr. 42, datë 16.01.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Ku kjo kategori kër kohet për çdo punë ndërtimi ku ka shtrim rrugësh, rikonstruksione ose ndërtim banesash, punime ndërtimi, gjermim kanali etj sepse ai merret me rlevimit e tokës, kuarot, profile tërthero dhe gjatësore, piketimet

Në Lidhjen 4 “Klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi” të VKM-së nr. 42, është vënë dhe kategoria A për të gjitha kategoritë e kërkuar sipas nivelit nga 0 deri në 20 milion lekë .

**2.3.3.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë :

- |                       |         |
|-----------------------|---------|
| 1) Inxhinier Ndërtimi | 1 (një) |
| 2) Inxhinier Topograf | 1 (një) |

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë :

*Për secilin pjestar te stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë kontrate pune e vlefshme, diplomë, librezë pune dhe CV, (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi)*

***Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.***

Në rastin konkret synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë staf të kualifikuar teknik për kryerjen e punimeve objekt kontrate.

Në nenin 8 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” parashikohet se “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.” Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane. Me materiale dhe produkte ndërtimi kuptohet çdo produkt i prodhuar për t'u përfshirë në mënyrë të përhershme në punimet e ndërtimit.”

Sa më sipër, në interpretim të dispozitave të mësipërme, zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga personat të pajisur me licencë të cilët njëherazi mbajnë përgjegjësi për realizimin e punimeve në përputhje me kushtet e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor. Lidhur me disponueshmërinë e Inxhinierëve të mësipërm, njësia e prokurimit gjykon se për sa kohë që autoriteti kontraktor në preventivin e punimeve ka parashikuar punime të një natyre në të cilën shfaqet e nevojshme disponueshmëria i një Inxhinier ndërtimi, dhe Topograf parë kjo në raport edhe me pikat dhe kategoritë përkatëse të licencës së kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, dhe referuar volumeve të punimeve të parashikuara në preventivin dhe në projektin përkatës, kriteri i mësipërm është në përputhje dhe proporcion me volumin e kontratës, si dhe në raport me kohëzgjatjen e zbatimit të punimeve të parashikuar, vlerën dhe natyrën e saj, është një kërkesë në përpjestim me natyrën dhe objektin e punimeve dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme.

***Argumentimi:*** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses

të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

➤ **Inxhinier Ndërtimi 1 (një)**

Duke analizuar preventivin e punimeve, si dhe referuar objektin të prokurimit i cili është “Rikualifikim i rrugëve Veiz Patriku, Labëria dhe sheshit të Perondisë”, disponueshmëria nga ana e operatorëve ekonomik ofertues të një inxhinier ndërtimi, si dhe mendimi i tij i specializuar ndihmon në zbatimin e kontratës me sukses duke arritur qëllimin e autoritetit kontraktor që përpos punimeve që do të kryhen, të kryejë një rrugë me standarte dhe punime sipas kushteve teknike, në përputhje me cilësinë që kërkon autoriteti kontraktor.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kërkesa për një inxhinier ndërtimi, është një kërkesë në përputhje me preventivin e punimeve dhe garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses dhe në kohë.

➤ **Inxhinier Topograf 1 (një)**

Inxhinier topograf kërkohet për çdo punë ndërtimi ku ka shtrim rrugësh, rikonstruksione ose ndërtim banesash, punime ndërtimi, gërmim kanali etj sepse ai merret me rilevimit e tokës, kuatot, profile tërthero dhe gjatësore, piketimet etj. Prania e topografit është e domosdoshme në terren për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë duke i dhënë garanci autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses.

**2.3.4** Operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë **punonjës të specializuar / të kualifikuar**, për të paktën 3 (tre) muajt e fundit si staf teknik punonjësit si më poshtë :

NR	EMËRTIMI	PUNONJËS
1	Shofer (drejtues kamioni)	4 (katër)

2	Automakinist	1 (një)
3	Buldozerist	1 (një)
4	Mekanik	1 (një)
5	Teknik ndërtimi	2 (dy)
6	Karpentier	1 (një)
7	Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave	1 (një)
8	Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë	1 (një)
Totali 12 (dymbëdhjetë) punonjës		

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë ofertues duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve të mësipërm në përputhje me shtojcën 8 .*

**Përpara lidhjes së kontratës për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë :**

Dëshmi kualifikimit të sigurimit teknik të cilat të jenë të lëshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, *ose çertifikata ekuivalente të tyre (të vlefshme)*, kontrate pune e vlefshme.

Për manovratorët të paraqitet kontrata e punës dhe dëshmia e aftësisë profesionale lëshuar nga DPSHTRR.

Në rastin kur mjetet e kërkuar më poshtë në pikën **2.3.7** janë me qera nuk është kusht që shoferët të jenë në listpagesën e shoqërisë, ata do të lejohen të plotësohen nga ofertuesit **edhe nëpërmjet kontraktimit për këtë objekt prokurimi.**

- 1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë/ ose çertifikatë trajnimi si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” të lëshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, *ose çertifikata ekuivalente të tyre (të vlefshme)*, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.
- Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre **1 (një)** punonjës të pajisur me çertifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëritë e akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga

Republika e Shqipërisë. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit, e dhënë nga një organizem i licencuar, shqiptar ose i huaj, si edhe të figurojë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit.

*(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, mbështetës dhe të specializuar/kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale, apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime /kualifikime).*

**Argumentimi në lidhje me pikën 2.3.4.** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Njësia e prokurimit sqaron se të gjithë punonjësit e kërkuar si më sipër me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik apo çertifikata ekuivalente të tyre, përkojnë me punimet sipas preventivit të publikuar në SPE, dhe konkretisht :

**Për automakinist 1 (një) punonjës, buldozerist 1 (një) punonjës si dhe shofer 4 (katër) punonjës.**

Njësia e prokurimit gjykon se punimet e parashikuara në preventivin e kontratës objekt prokurimi, ku parashikohet shtrimi i shtresës së asfaltbetonit me makineri autobitumatriçe dhe asfaltoshtruese në sasinë 8800 m<sup>2</sup>, ku parashikohet shtrimi i rrugës me shtresë çakëlli në sasinë dhe shtresë stabilizanti, garanton autoritetit kontraktor që ofertuesit duhet të disponojnë drejtues për makineri të rënda për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë, për sa kohë disponueshmëria e tyre lidhet drejtëpërdrejtë me manovrimin e mjeteve si Kamiona vetshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 20 ton 2 (dy copë), dhe minimumi 10 ton 2 (dy) copë për transportimin e mallrave të mësipërm pranë kantierit të ndërtimit, Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton 1 (një) copë, Grejder 1 (një) copë, Asfaltoshtruese 1 (një) copë, Autobitumatriçe 1 (një) copë, Rrul asfalti hekuri 1 (një) copë, Rrul ngjeshës me gomë 1 (një) copë për ngjeshjen sistemimin e çakullit dhe stabilizantit.

Akoma më tej, kriteri i mësipërm është lënë i hapur për tu plotësuar nga ofertuesit për sa kohë disponimi i tyre lejohet të përmbushet edhe nëpërmjet nënkontraktimit në rastet kur mjetet e kërkuar më poshtë sipas pikës 2.3.7 janë me qera.

## **Për Mekanik 1 (një) person**

Njësia e prokurimit gjykon se punimet e parashikuara në preventivin e kontratës objekt prokurimi, kërkojnë një numër të konsiderueshëm për mjete dhe pajisjesh teknike (ku puna më e madhe do të kryhet nga këto mjete). Përcaktimi i kriterit për disponimin e 1 (një) mekaniku për mirëmbajtjen e tyre me qëllim që puna mos të pezullohet asnjëher, është i domosdoshme për të mbikqyrur makineritë dhe mekanizmat që nevojiten për kryerjen e këtyre punimeve.

**Për teknik ndërtimi 2 (dy) persona, për Karpentier 1 (një) person** të pajisur me dëshmi aftësie profesionale, nevojitet prezenca e tyre në kantier duke garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses si punime për sistemimin e shtresës së çakullit dhe stabilizantit në gjithë gjatësinë e rrugës përpara ngjeshjes së saj me makineri,

Referuar preventivit të punimeve si Mur betoni c12/15, themel e xoko betony, ndërtim kasonete njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësish për zbatimin e këtyre zërave duke garantuar autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses dhe në kohë.

- Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave
- Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë

Njësia e prokurimit e gjykon së kërkesa e mësipërme është në përputhje me objektin e kontratës, për shkak se garantimi i ekspertit së mbrojtjes e shëndetit në punë nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Kriteri i mësipërm lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë autoriteti kontraktor ka pranuar edhe disponimin me certifikata trajnime apo certifikata ekuivalente të tyre, duke i shërbyer autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës, si dhe duke lehtësuar operatorët ekonomik ofertues në përmbushjen e këtij kriteri.

Kërkesat e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "*Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"* si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 "*Për mbrojtjen e mjedisit*". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri dhe përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e

sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilet janë të çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe kontrollin e cilësisë" dhe "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave", janë të nevojshëm për të menaxhuar emergjencat gjatë punimeve dhe të sigurojnë mbrojtjen e shëndetit në punë.

**2.3.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtoare prej minimalisht 14 (katërbëdhjetë) persona, dhe të jenë në listëpagesën e shoqërisë në momentin e hapjes së tenderit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë ofertues duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për tre muajt e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8 .

Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë :

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit, për periudhën **si më sipër**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **si më sipër**.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtoare të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit,që

ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Referuar legjislacionit në fuqi, është përcaktuar se autoriteti kontraktues kërkon dëshmi për fuqinë punëtore me qëllim që të garantohet për realizimin me sukses të kontratës.

Si dhe referuar përmasave të kontratës që do të do të prokurohet, specifikimeve teknike, fondit limit, afatit të zbatimit të saj, si dhe kohëzgjatjes së parashikuar për realizimin e punimeve gjithësej 3 (tre) muaj, njësia e prokurimit vlerëson se numri i punonjësve të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor në rastin konkret, garantohet për zbatimin e kontratës me sukses duke krijuar besueshmerinë dhe qëndrueshmëri të punonjësve tek operatorët ekonomik, si dhe duke mos sjellë vonesa në zbatimin e saj.

Lidhur me përcaktimin e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka mbajtur në konsideratë Rekomandimin e APP Nr 4916/2 Prot të datë 14.07.2022, pika 3, ku përcaktohet se autoritetet kontraktore duhet të hartojnë kërkesat e veçanta të kualifikimit në përputhje me nenet 77 të LPP dhe 78 të VKM, si dhe legjislacionit të fushës përkatës, duke argumentuar domosdoshmërinë e tyre në çdo rast.

Bazuar mbi rekomandimin e APP, njësia e prokurimit ka hartuar analizën teknike ku parashikohet fuqia punëtore duke u bazuar në preventivin e punimeve si dhe afateve kohore të parashikuar në grafikun e punimeve dhe mbi bazën e analizave përkatëse ka përcaktuar numrin e saktë/ose minimal të punonjësve që nevojiten për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë, duke përcaktuar secilin punonjës me kualifikim e duhur, gjithçka në funksion të objektin të kontratës.

Nga përlllogaritja e mësipërme, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për 14 (katërbëdhjetë) punonjës të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

**2.3.6** Operatorët ekonomik ofertues duhet të jenë të certifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, dhe konkretisht :



- ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë e vlefshme ), *ose ekuivalent*
- ISO 14001-2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor e vlefshme), *ose ekuivalent*
- OHSAS 45001-2023 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë e vlefshme), *ose ekuivalent*.
- ISO 39001:2012 mbi “Sistemi i menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor” e vlefshme, *ose ekuivalente*.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Për vetë natyrën e veçantë dhe delikate, dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet si dhe afatit për zbatimin e saj.

Kjo çertifikatë lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohet edhe çertifikata ekuivalente të tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë çertifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardin për menaxhimin e mjedisit për sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtëpërdrejtë në mjedis.

ISO ( Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit ) është një organizatë me anëtarësi e pavarur, jo-qeveritare dhe zhvilluesi më i madh në botë i Standardeve Ndërkombëtare, nga 163 vende të botës. ISO publikon më shumë se 19500 Standarde Ndërkombëtare, të cilat mbulojnë pothuajse çdo fushë industrie, nga teknologjia te siguria ushqimore, bujqësia e shëndeti. Në nivel botëror shoqëritë ndjekin adoptimin e standarteve të cilësisë me qëllim që të jenë të respektuar nga klientet e autoritetet shtetërore dhe të ndërtojnë bashkëpunim të qendrushëm me avantazhe reciproke.

➤ **ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalent**

Për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të cilësisë, është standarti më i njohur që është publikuar ndonjëherë në nivel nderkombëtar. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxhial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilën AK kërkon ta kryejë me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, preventivin dhe vlerën

e saj, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij që të kërkoj certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, që përpos punimeve që do të kryhen nga operatorët ekonomik ofertues, këto punime të kryhen me cilësi sipas certifikatës iso të mësipërme.

➤ **ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit te ambientit” e vlefshme, ose ekuivalent**

Ky certifikim shërben në lidhje me sistemet e menaxhimit mjedisor, me anë të së cilës garantohen mundësitë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një subjekti me synim parandalimin e dëmtimit të mjedisit, respektimin e legjislacionit vendas në lidhje me mjedisin dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Gjithashtu, ky certifikim fokusohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të subjektit, duke bërë të mundur të përmirësohet ndikimi i veprimtarisë së përgjithshme të subjektit në aspektin mjedisor.

Kjo certifikat është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Referuar objektit të prokurimit në rastin konkret, njësia e prokurimit e ka parë të nevojshme që shoqëritë të jenë të certifikuara nga organizata ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit të mjedisit sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi të, duke kryer një proces riaftësimi më pas të ambientit përreth ku do të kryhet investimi.

➤ **ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë e vlefshme) ose ekuivalentet e tyre**

Është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar që përcakton kërkesat për një sistem manaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë .

Kjo certifikatë garanton sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve që marrin pjesë gjatë një procesi prodhimi apo kryerjes së një veprimtarie apo pune publike e cila vë apo mund të vërë në rezik shëndetin dhe jetën e punonjësve . Është e lidhur ngushtë dhe në përpjestim me objektin e kontratës, sipas parashikimeve të LPP.

Autoriteti kontraktor përpos punimeve që do të kryejë, kërkon që këto punime ti zhvillojë në përputhje dhe garanci të plotë me sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve .

➤ **ISO 39001:2012 mbi “Sistemi i menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor” e vlefshme, ose ekuivalente .**

Ky certifikim shërben në lidhje me sistemet e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor, që është një çështje delikate dhe aktuale, me anë të së cilës garantohen mundësitë e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor të një subjekti me synim parandalimin e aksidenteve dhe trafikun në

rrugë, në respektimin e legjislacionit vendas në lidhje me sinjalistikën rrugore. Gjithashtu, ky çertifikim fokusohet në njohjen e të gjitha aspekteve në menaxhimin e sigurisë të trafikut rrugor, duke bërë të mundur të përmirësohet ndikimi i veprimtarisë së përgjithshme të subjektit në këtë aspekt .

Standardi ndërkombëtar ISO 39001 është zhvilluar me qëllim për të ndihmuar në përmirësimin e sigurisë në trafikun rrugor. Ai cakton rregullat për një sistem menaxhimi i cili mund të implementohet nga çdo shoqëri e cila ndërton, projekton, administron apo përdor infrastrukturën rrugore.

ISO 39001 është zhvilluar me pjesëmarrjen e disa organizatave ndërkombëtare si Organizata Botërore e Shëndetësisë, Banka Botërore apo Federata Ndërkombëtare e Rrugëve.

Ky standard përfshin kërkesat që kanë të bëjnë me zhvillimin e një politike në lidhje me sigurinë në trafikun rrugor, ndërgjegjësimin e shoferëve, monitorimin e gjendjes teknike të automjeteve, përgatitjen për situata emergjente apo hetimin e aksidenteve në trafik.

Kjo çertifikat është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Referuar objektit të prokurimit në rastin konkret, njësia e prokurimit e ka parë të nevojshme që shoqëritë të jenë të çertifikuara nga organizata ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit të **sigurisë në trafikun rrugor**, për sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë sepse kemi të bëjmë me një Rikualifikim i disa rrugëve të brendshme, në lagje me një popullsi me densitet të lartë.

**2.3.7** Operatorët ekonomik ofertues për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet teknike si më mëposhtme :

***Për përmbushjen e kesaj pikës, operatorët ekonomikë ofertues duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve të mësipërm në përputhje me shtojcën 8.***

Nr	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Kamiona vetshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 20 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
2	Kamiona vetshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 10 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
3	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
4	Grejder	1 copë	Pronësi ose me qera
5	Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera
6	Autobitumatriçe	1 copë	Pronësi ose me qera
7	Rrul asfalti hekuri	1 copë	Pronësi ose me qera
8	Rrul ngjeshës me gomë	1 copë	Pronësi ose me qera
9	G.P.S ose Total Station		
10	Nyje inertesh	1 copë	Pronësi, me qera ose

			kontratë furnizimi
11	Fabrikë asfaltobetoni	1 copë	Pronësi, me qera ose kontratë furnizimi

- a) *Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik si dhe çertifikatën e transportit të mallrave (të vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) si dhe taksat.*
- b) *Për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik si dhe çertifikatën e transportit të mallrave (të vlefshme), siguracionin e mjetit, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*

*Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*

- c) *Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.*
- d) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës përkatëse. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- e) *Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara më sipër do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak për skualifikim. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës .*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar ligjvënësi i jep të drejtën autoritetit kontraktor të kërkojë nga ana e operatorëve ekonomik dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit

përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve të ndërtimit dhe preventivit të hartuar nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Kuçovë, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve. Për realizimin e kontratës me sukses dhe në kohë autoriteti kontraktor kërkon garanci nga operatorët ekonomik ofertues të cilët duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme, gjithçka në funksion të zbatimit të kontratës.

Duke parë volume e punimeve, afatin për realizimin e saj, vlerën e kontratës, relacionin teknik është e nevojshme që operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se disponojnë mjetet e mësipërme për realizimin me sukses dhe në kohë të objektit të prokurimit .

### **Analizë të detajuar në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që kërkohen nga autoriteti kontraktor :**

- Në lidhje me kamion vetëshkarkues 2 copë me kapacitet minimumi 20 ton dhe 2 copë me kapacitet mbajtës min 10 ton njësia e prokurimit është bazuar në preventivin e punimeve duke analizuar proceset e punës që do të zhvillohen në volume të mëdha të cilat janë të domosdoshëm prania e mjeteve të mësipërme për transportimin e të gjitha materialeve të ndërtimit pranë kantierit dhe më konkretisht, për zërat shtresë çakëlli mbeturina kave t=10cm, shtresë stabilizanti 10cm, disponueshmëria e mjeteve të sipërcituar garanton AK për zbatimin e kontratës me sukses.

Nga proceset e punës të listuar si më sipër, si dhe duke u bazuar në grafikun e punimeve të ndërtimit ku është parashikuar për 30 ditë që të përfundojnë shtrimi i çakullit, dhe 30 ditë shtrimi i stabilizantit njësia e prokurimit gjykon se ka parashikuar një numër minimal mjeteve me qëllim zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

- Në lidhje me Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton, njësia e prokurimit sqaron se janë të nevojshëm për transportimin dhe sistemimin e materialeve të ndërtimit pranë kantierit në ato vende ku nuk mund të futen kamionat e mëdhenj me kapacitet mbajtës 20 dhe 10 ton. Duke qënë se në këtë lagje, do të shtrohen disa rrugica të vogla, mjeti i sipërcituar do të kryej të gjitha proceset e punës sipas preventivit të punimeve.
- Në lidhje me, Rrul ngjeshës me gomë 1 copë, rrul asfati hekuri dhe Grejder 1 copë.

Njësia e prokurimit sqaron se mjeti Grejder është i domosdoshme për nivelimin e çakëllin, kurse mjeti Rrul ngeshës me gomë është i nevojshëm për ngjeshjen e stabilizantit dhe granilit . Si dhe rrul asfalti hekuri është i nevojshëm për ngjeshjen e asfaltobetonit.

Disponimi i mjeteve të mësipërm nga ana e ofertuesve garanton autoritetin kontraktor që zbatimi i punimeve të kryhet në kohë dhe në përputhje me grafikun e punimeve.

- Në lidhje me Asfaltoshtruese 1 copë, dhe Autobitumatrice 1 copë, njësia e prokurimit është bazuar në preventivin e punimeve duke analizuar proceset e punës që do të zhvillohen të cilat janë të domosdosshëm prania e mjeteve të mësipërme për zërat e preventivit dhe më konkretisht :  
Për zërin Shtresë asfaltobetonit me zall lavatriçe, 6 cm me makineri.  
Autobitumatriçe është e nevojshme për hedhjen e prajmerit (që hap lëngun para shtrimit të asfaltit).  
Asfaltoshtruesja është e nevojshme për shtrimin e asfaltit. Rrul asfalti hekuri 1 copë është i nevojshëm për ngjeshjen e asfaltit.  
Disponimi i mjeteve të mësipërm nga ana e ofertuesve garanton autoritetin kontraktor që zbatimi i punimeve të kryhet në kohë dhe në përputhje me grafikun dhe preventivin e punimeve.
  
- G.P.S ose Total Station kërkohet pasi kemi matje topografike përsa i përket rievimeve dhe sistemimeve të jashtme.

**Lidhur me kërkesën për Fabrikë asfaltobetonit dhe Impiant inertesh** ku ofertuesit duhet ti disponojnë në pronësi, me qira ose kontratë furnizimi, njësia e prokurimit argumenton se :

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe

kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Bazuar dhe në preventivin e punimeve, specifikimeve teknike dhe relacionit teknik, kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë ofertues të 1 (një) impiant për prodhimin e asfaltit dhe 1 (një) impiant inertesh, në vetvete nuk është një kriter diskriminues dhe i pamundur për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret është në të drejtën e autoritetit të kërkojë garanci lidhur me mundësitë e operatorëve ekonomik për sigurimin e lëndës bazë dhe materialeve që do të përdoren për realizimin e objektit, përsa kohë lejohet provueshmëria e disponimit nëpërmjet edhe kontratave të furnizimit sikurse autoriteti kontraktor ka përcaktuar në DST, duke e lenë të hapur përmbushjen e këtij kriteri në respekt të plotë të ligjit të prokurimit publik, duke rritur eficientën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore duke nxitur njëkohësisht pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik .

*Në preventin e punimeve, autoriteti kontraktor ka parashikuar punime si Shtresë asfaltobetoni me zall lavatriçe 6 cm me makineri, si dhe Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, përhapur e ngjeshur makineri në sasinë 8800, dhe 3.212/b Shtrese stabilizanti 10cm.*

Duke parë volume e mëdha të punës që do të kryhen, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij të kërkojë garanci nga ofertuesit për përmbushjen me sukses të çdo zëri të preventivit të punimeve.

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".*

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve*

që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

## **NJËSIA E PROKURIMIT**

**Alma ELEZI**

**Emiliano AGAJ**

**Sherla PUTRO**